

BESARTA QALLIAJ

VËSHTRIM LEKSIKO-STILISTIK NË PROZËN E E. KOLIQIT

Krijimtaria e shkrimtarëve të njohur është bërë shpesh pjesë e studimeve letrare, por edhe gjuhësore, sepse shkrimtarët përbejnë lëvruesit kryesorë të gjuhës. Në këtë punim objekt është bërë proza e Koliqit. Ernest Koliqi është personalitet i shquar dhe krijues i gjithanshëm që lëvroi shumë fusha: poezinë, prozën, publicistikën, studimin shkencor, por mbi të gjitha ai mbetet një shkrimtar me përmasa të mëdha. Koliqi jo vetëm shkroi një shqipe aq të pasur dhe të hirshme, por edhe gjatë gjithë jetës së tij nuk kurseu të gjente rastin për të shprehur edhe vlerësimet e tij të larta për gjuhën shqipe. Në prozën poetike që titullohet “Bukurija e gjuhës shqipe” Koliqi shkruan:

“Gjuha e jonë asht e bukur. Nuk e tham kët pse si Shqiptar më duhet me lavdue gjuhën shqipe, por pse jami i bindun qi kemi një gjuhë në vetvete të bukur. A e keni mendue ndonji herë bukurinë e këtyre zaneve qi lëvizin nëpër buzët t’ona? Fjalët as nuk shifen, as nuk preken, e pra kanë ma qendrim e konsistencë se na qi jemi mishit e gjakut. Para njimijë, dymijë vjetve kishte njerëz qi dojshin, mniyshin, urojshin, namshin me shumicën e fjalve qi na sot përdorojmë, e më sa ata u shuen në heshtjen ma të plotë, këto jetojnë e qarkullojnë e shërbejnë gjithënji me shprehë dashunin, mënin, me ba urime e me hjedhë namë. Fjalët as nuk shifen, as nuk preken, por në to asht drita e panjehun e syve qi nënqeshin tue i folë, dridhja e buzëve të njoma e të rrudhuna qi i shqiptuene, loti e gazi i njqind gjeneratave të sosuna. Ata sy e ata buzë u fikën e ftofën, ai gaz u shue e ajo lode u tha, por fjalët shqipe fluturojnë gjithënji gojë në gojë, gjatë shekujve, e këndojnë papushue ndër gzime e qajnë papushue ndër mjerime, të pavdekshme, të përjetshme.”¹

Dhe këtë pjesë e përmbyll me fjalinë kuptimplote “Gjuha e jonë asht e bukur sidomos pse asht e vjetër.”

Siç shihet, ky personalitet ecën në hullinë e rilindësve të mëdhenj kur evokon e lartëson lashtësinë dhe shenjën më të patjetërsueshme të etnitetit dhe identitetit të shqiptarëve, gjuhën amtare. Ai shkroi poezinë "Gjuha shqipe", siç bënë Naimi, Mjeda, Fishta, Poradeci, Kuteli. Shqipja për të është “gjuhë e folun për trimij pranvera..., gjuhë e folun n’botë ende ferishte”, është gjuhë që “lshon amë ilire n’goje agimesh s’vjetra” dhe që “prej gojve arbnore” nuk u hoq, është gjuha që “tok na mbajti ndër pushtime t’hueja dhe “zanin na e dridh’ me një kreni t’pashoqe”. Ai shkroi në shqip, por edhe e përktheu në

¹E. Koliqi, *Vepra*, 2, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 297-298.

shqipe apo prej shqipes dhe në vazhdimësi e pasuroi atë në të gjitha nënsistemet, veçanërisht në leksik.

Janë bërë përpjekje për t'u marrë me leksikun e veprës së E. Koloqit², por puna është vetëm në fillesat e veta³. Gjuhëtarë të njohur që e kanë studiuar veprën e këtij shkrimtari kanë vënë re se ajo “shquhet për leksikun e saj të pasur e të larmishëm, për sintaksën e thjeshtë dhe të zhdërvjellët, për figurshmërinë e përpunuar me mjeshtëri, të cilat e bëjnë stilin e tij origjinal dhe tërheqës.”⁴

Leksiku i veprës së E. Koloqit përfshin *njësi të njohura, pak të njohura e njësi të panjohura*. Fjalori i veprës së tij përbëhet nga dy grupe të mëdha njësisht: *grupi i njësive nga leksiku i gjuhës amtare dhe grupi i njësive të krijuar nga vetë Koliqi*.

Gjithashtu, është vërejtur se tri janë burimet e pasurisë leksikore në veprën e tij:

Burimi i parë është *gjuha e vendlindjes*, e folmja e Shkodrës dhe kur ishte në Itali, *të folmet arbëreshe*. E. Koliqi më 1931 shkruan: *Gjuha e jonë burimin e vet të pashtershëm e ka në popull. Fjalë, thanje janë mbledh mjaft, gjithnjë mblidhen, prap të tjera do të gjinden qi do të hyjnë në përdorim ma vonë. Por nuk flas për këtë studim makinal, i cilli asht i detyrueshëm për çdo Shqiptar. Randësi shumë ma të madhe ka studimi i atij ritmi të çudiçëm qi merr gjuha e jonë në gojë të popullit, kuptimi i saj muzike qi jehon në fjalët e njerëzve të paprishur nga letërsitë e hueja. Kur flasin njerëzit pa shkrim e pa këndim, një melodi e pazaptueshme rrëshqet në rreshtimin e fjalëve të tyne; thanja u del e njomë, fjalija ka lakime mrekullisht të bukura e të zhdërvjellëta, lidhjet janë mjeshtërore e të natyrshme. At melodi, ato karakteristika duhet të përpiqemi me shti në stil t'onë për në daçim me shpreh ma s'miri ndiesit e thella qi msheh shpirti i kombit”⁵.*

Burimi i dytë është *folklori*, gjuha e krijimeve popullore si gojëdhënat, këngët, përrallat, eposi i kreshnikëve etj., rreth të cilave bëri studime dhe mbrojtje tezën e doktoraturës.

Burimi i tretë është *gjuha e trashëgimisë së kulturës italiane e botërore*. E. Koliqi, qysh herët, kur shkollohej në Itali, mori një kulturë të gjerë sidomos

² Veçojmë këtu T. Osmani, *Çështje të leksikut dhe të fjalëformimit në faqet e një reviste*, në “Gjuha dhe shkrimtari”, Shkodër, 2001; M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006 etj.

³ Është vlerësuar e duhet vlerësuar puna e bërë nga M. Elezit te *Fjalori i gjuhës shqipe* që pasqyron një pjesë nga kjo pasuri. *Shih më gjerë M. Elezi, Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.

⁴ S. Mansaku, *Vepra e Ernest Koliqit e vështruar në rrafshin gjuhësor*, Gjuha jonë, Nr. 1-2/2003, f. 94-95.

⁵ E. Koliqi, *Vepra*, 2, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 297.

latino-italiane, prej së cilës mori e dha. Ai vlerësohet si përkthyesi më i mirë që kemi pasur nga italishtja e frëngjishtja në shqip, sikurse nga shqipja në italishte. E. Koliqi i pari që përballoi përkthimin e poetëve të mëdhenj, si Petrarca, Dante Aligheri, Tasso, Aristo, Foscolo, Carducci, Pascoli, D'Annunzio, Baudlaire, Maeterlinck, Verhaeren etj.

Përdorimi i një leksiku mjaft të pasur ka qenë jo vetëm pasion e dëshirë, por synim parësor i Koliqit. Te romani "Shija e bukës së mbrume" ai shkruan se "me dyqind fjalë të mësueme në rreth shtëpiak nuk krijohet një letërsi". Për këtë autor "shqipja asht gjuhë e pasun dhe sqimatare" dhe sqaron se ajo "ka në vetvete gjallni kromatike e hire muzikore ende të pazbulueme, të cilat, kur të dalin në shesh nëpër lavrim të palodhur të shkrimtarëve që ushtrojnë me vetëdijë të ndritun zëjen e tyne, do të jenë kënaqja e krenaja e breznive të përtardhuna..."⁶

Pos fjalëve të brumit shqip në gjuhën e veprës së Ernest Koliqit takohen fjalë të ndryshme me prejardhje joshqipe. Ato janë huazime nga periudha të ndryshme të kontakteve të shqipes me gjuhë të tjera ose huazime të hyra në shqipe përmes një gjuhe të tretë. Huazimet leksikore në gjuhën e veprës së Koliqit më shumë janë vështruar sipas llojit dhe vlerës së tyre përdoruese. Koliqi në gjuhën e veprës së tij leksikun me prejardhje të huaj, posaçërisht atë oriental, gjuhësisht e shfrytëzon për përftesa shprehëse. Përmes tyre bën tipizimin e karaktereve, si dhe përshkrimin e situatës në të cilën zhvillohet fabula e rrëfimit. Shumica e huazimeve që dalin në veprën e këtij shkrimtari janë të fazës së hershme të shqipes dhe si të tilla në këtë punim ato kanë mbetur jashtë interpretimit etimologjik. Kjo bëhet për faktin se huazimet e hershme sot janë pjesë e leksikut aktiv.

Në gjuhën e veprës së këtij autori përdoren fjalë të huazuara nga gjuhë të ndryshme.

Sipas origjinës këto huazime i kemi klasifikuar në grupe të veçanta, si: *huazime greke, neolatine, sllave dhe orientale*. Këto të fundit zënë vendin kryesor në veprën e tij, posaçërisht në veprat e botuara në periudhën e parë të krijimtarisë së tij. Ato përdoren si burim i pashtershëm përftesash stilistike. Madje në shkrimin "*Ndikime orientale në letërsinë shqiptare*" vetë Koliqi sqaron qëndrimin e tij ndaj orientalizmeve.

"Madje, kryesisht kundra skajeve turke pati tepri aq fanatike neverie same shkaktue një kundërveprim plot mend të vetë Fishtës, i cili në një satirë të veten, tue i dhanë gjallni një përshkrimi të ambjentit e të zakoneve me një fjalë shumë të përshtatshme turke, shtoi ndër kllapa vargun në zâ: *Ka'j fjal'turçe bân lazem!*"

⁶ E. Koliqi, *Shija e bukës së mbrume*, Shkodër, 1996, f. 12

Ky qëndrim arsyeton gjithë përdorimin e fjalëve të origjinës orientale në veprën e tij. Ai e kishte të qartë se eliminimi i tërësishëm i huazimeve nga gjuha shqipe, posaçërisht nga letërsia e shkruar, ishte i dëmshëm pasi ato konsiderohen mjete të rëndësishme gjuhësore për ndërtimin e tekstit letrar dhe të stilit. P.sh... U shitne a s'u shitne flámujt, qëndroi a s'qëndroi Shqipnija, un kam mjaft, shyqyr, me jetue.... Novela : ("Tregtar flamujsh", f. 175), ai ishte prisi shokve ndër qefe e mbreti i ahengjeve qytetare.. Tregimi: "Te tre lisat ", ("Hija e maleve", f. 133), -Pse u apin gjith at randsí vetit, xhanem? Novela : ("Tregtar flamujsh", f. 185), Baba em, rahmet pastë, më thotë gjithmonë se nën kalá të Drishtit ka gjâna të kushtueshme gropue në dhé. Tregimi: "Djepi arit " (Pasqyrat Narçizit", f. 284), .i a lëmojshin sedren..... Romani: (Shija e bukës mbrume, f. 35), Pushka e trimit dhe sofa e gjymertit nuk priten! Romani: (Shija e bukës mbrume, f. 178).

Shembujt e mësipërm tregojnë se Koliqi ka përdorur orientalizmat si leksema për përftesa stilistike. Me ndihmën e tyre autori përshkruan gjendje emocionale (xhanem, rahmet, sedren), por edhe vendin e ngjarjes, situatën.

Duke përfunduar mund të themi se Koliqi nuk ndoqi rrugën e purizmit ekstrem, por as nuk e teproi me përdorimin e fjalëve joshqipe. Hulumtimi ynë e nxjerr Koliqin të vëmendshëm në përdorimin e leksikut për efekte stilistike. Veprat e hulumtuara në këtë plan nxjerrin në dritë të vërtetën se shkrimtari i përmasave të mëdha, pa ndonjë përgatitje gjuhësore, kishte respekt për gjuhën dhe në këtë qëndrim gjithë leksiku i huaj më tepër ishte përdorur për përftesa stilistike.